

Në bazë të nenit 184 të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe neneve 264 dhe 265 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Komisioni për çështje mësimore – shkencoredhe Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar, pas pranimit të Nismës nga Rektori i Universitetit të Tetovës Prof. Dr. Vullnet Ameti për ndarjen e titullit **Doktor nderi - Doctor Honoris Causa për z. Mirush Kabashi**, e formoi Komisionin recensues, në përbërje:

1. Prof. Mr. Nafi Jashari - kryetar
2. Prof. Dr. Salajdin Salihu - anëtar
3. Prof. Miltiadh Kutali – anëtar

Për këtë qëllim, si anëtarë të Komisionit recensues kemi kënaqësinë dhe nderin e veçantë që deri tek organet e Universitetit ta paraqesim këtë:

REFERAT

për dhënien e titullit *Doctor Honoris Causa* për z. Mirush Kabashi

Universiteti i Tetovës është vlerë e shenjtëruar jo vetëm për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, por për mbarë botën shqiptare. Ky institucion arsimor, me vlera të larta arsimore, shkencore, emancipuese dhe kulturore, ka ndikuar dhe ndikon fuqishëm për ngritjen kulturore dhe qytetare të kësaj pjese të botës shqiptare.

Drejtuesit e Universitetit të Tetovës, që nga themelimi i tij, e kanë pasur synim parësor respektimin e figurave të rëndësishme të artit, kulturës, shkencës dhe historisë sonë. Shumë figura të rëndësishme shqiptare kanë dhënë kontribut të madh edhe për Universitetin e Tetovës, që konsiderohet si e arritura më e madhe historike kombëtare për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut.

Në këtë universitet, që është formësuar nëpërmjet ngulmimit, sakrificës dhe idealizmit të arsimdashësve, përherë janë përkrahur dhe janë nxitur projektet për bashkëpunimin kulturor brenda hapësirës shqiptare, njëkohësisht janë nxitur dhe janë përkrahur projektet për bashkëpunime ndërkulturore e ndëretnike, me synimin që kjo botë të jetë më e paqme, më e denjë për të jetuar. Është vlerësuar se nëpërmjet shkëmbimit të vlerave kulmore pasurohen sistemet kulturore dhe krijohen ura afrimi dhe miqësie ndërmjet kombeve.

Universiteti i Tetovës është kurorëzim i idealit të shumë brezave, kurse lartësimi i këtij institucioni është bërë falë përpjekjes së përbashkët të popullatës, intelektualëve, faktorit politik shqiptar, diasporës dhe humanistëve e filantropëve të trevave tona.

Jemi krenarë që festojmë edhe një përvjetor të themelimit të UT. Kjo festë bëhet më e veçantë edhe me laureimin me titullin e doktorit të nderit të z. Mirush Kabashit, një aktor, intelektual dhe pedagog i respektuar në hapësirën shqiptare e më gjerë.

Me qëllim që t'i zbatojmë me përpikëri procedurat ligjore dhe statutare, kemi hartuar referatin për këtë ngjarje të veçantë, që për ne si Komision vlerësues ka qenë kënaqësi dhe privilegj, sepse kështu komunitetit akademik dhe opinionit publik ia përçojmë mesazhin fisnik se Universiteti i Tetovës di t'i çmojë figurat e rëndësishme të artit dhe kulturës sonë.

Me këtë Referat, që përmban pjesën biografike, arsyetimin e dhënies së titullit dhe pjesën përmblylëse, i propozojmë Senatit të Universitetit, që ta miratojë Vendimin për lauerimin e z. Mirush Kabashi Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës.

I. Të dhënat mbi jetën dhe veprimtarinë e z. Mirush Kabashi

Mirush Kabashi, me origjinë kosovare nga i ati, ka lindur më 17 prill 1948, në Shkodër, ku familja e tij ishte transferuar nga Durrësi.

Shkollimin fillor (ciklin shtatëvjeçar) dhe gjimnazin i kreu në Durrës, ku filloi të aktivizohej në konkurset teatrale midis shkollave, ku ra në sy edhe prirja e tij aktoriale.

Pasi fitoi konkursin, ai e mbaroi Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë dhe filloi me punë si aktor në Teatrin e Durrësit, ku punoi nga viti 1971 deri në 1993.

Në vitin 1994 u punësua në Televizionin Shtetëror në Tiranë, si ideator dhe prezantues i programeve artistike.

Në vitin 2002 u punësua si aktor në Teatrin Kombëtar, ku luajti në shumë shfaqje deri në vitin 2014, kur edhe doli në pension.

Jeta e aktorit është shoqëruar me shumë vështirësi. Në vitin 1974 u largua nga teatri për motive biografie. Daja i tij Skender Çela, sot "martir i demokracisë", ishte pushkatuar pa gjyq nga regjimi komunist, kurse daja tjetër, Hysen Çela, një njeri me kulturë të gjerë dhe poliglot, ishte dënuar po nga i njëjti regjim me 25 vjet burg të rëndë me akuzën se kishte bashkëpunuar me amerikanët. Sot një shkollë teknike mban emrin e tij. Me të njëjtën akuzë qe arrestuar në Shkodër edhe i ati i tij, Musai.

Aktori, Mirush Kabashi, në këtë periudhë, kishte punuar dy vjet si mekanik në hekurudhë. Pas këtyre vështirësive rikthehet sërish në teatër, njëkohësisht ai punoi edhe si pedagog i jashtëm i lëndës "Mjeshtri aktrimi" në Akademinë e Arteve.

Ndërmjet viteve 1991 dhe 1993, përveç aktrimit, ishte edhe drejtori Teatrit të Durrësit.

Mirush Kabashi, gjatë karrierës njëzet e tre vjeçare si aktor në teatrin e Durrësit, konsiderohet si aktori më i aktivizuar dhe më prodhimtar në teatër, me varietenë e Durrësit, si prezantues e ideator i shumë koncerteve artistike dhe aktiviteteve kombëtare televizive dhe si drejtues i shumë shfaqjeve skenike të grupeve amatore të ndërmarrjeve të rëndësishme dhe shkollave të mesme, ku shpesh u aktivizua edhe si aktor.

Mirush Kabashi ka luajtur mbi 100 role në teatër dhe në film. Ai për herë të parë i ka sjellë Teatrit të Durrësit, dy çmimet e rëndësishme interpretuese: "Aktori i dytë, më i mirë i vendit", në konkursin e madh të 45 vjetorit të Çlirimit, më 1984 dhe "Aktori më i mirë i vendit", më 1989, që ishte organizuar nga Festivali Kombëtar i Teatrit. Si "Aktori më i mirë i vendit" u vlerësua edhe në Festivalin Mbarëkombëtar të Aktrimit, më 2002.

Ai ka marrë vlerësime të shumta edhe për kontributin e tij në kinematografi.

Mirush Kabashi ka dhënë kontribut të madh edhe në proceset demokratike, qoftë si artist, qoftë si qytetar, duke prezantuar para publikut vepra që e provokonin sistemin monist dhe reflektonin mesazhe për lirinë dhe demokracinë e vendit.

Në vitin 1991 e realizoi recitalin poetik "Për demokracinë". Më 8 shkurt të vitit 1991, përderisa jepej recitali në teatër, në shesh zhvilloheshin përleshjet ndërmjet protestuesve dhe policisë, pikërisht për demokracinë. Kjo shfaqje u vlerësua nga kritika si manifestimi i parë artistik për demokracinë.

Kabashi, 25 vjet me vonë, e realizoi koncertin e dytë recital poetik, me titullin "Ah, moj demokraci".

Kontributi i tij si artist fitoi përmasë mbarëkombëtare gjatë luftës së Kosovës, ku me shumë artistë të tjerë frymëzoi të rinjtë shqiptarë për inkuadrimin në radhët e UÇK-së, njëkohësisht u bë pjesë e aksionit për grumbullimin e mjeteve financiare në mbështetje të lirisë së Kosovës.

Mirush Kabashi nuk pranoi asnjëherë që të angazhohej në parti politike. Ai beson se artisti në demokraci duhet të jetë vetëm zëdhënës i përgjegjshëm dhe i guximshëm i pjesës më të shëndoshë të shoqërisë dhe të përfaqësojë vetëm interesat e kombit të tij.

Mirush Kabashi ka shënuar sukses të veçantë me dramatizimin dhe inskenimin e novelës së shkrimtarit francez, Erich-Emmanuel Schmitt "Z. Ibrahim dhe lulet e Kuranit", që është shfaqur

në shumë qytete (Durrës, Tiranë, Shkodër, Prishtinë, Gjakovë, Tetovë, Toronto, Ulqin, Cyrih dhe Gjenevë).

Niveli më i lartë i interpretimit të tij aktoresk u shënuar në vitin tragjik 1997, me monodramën e parë të Teatrit Kombëtar Shqiptar, “Apologjia e vërtetë e Sokratit”, nga autori grek Kostas Varnalis, që ishte përshtatur dhe inskenuar nga Kabashi.

Kjo monodramë është shfaqur në skenat më prestigjioze të botës: Paris, Vjenë, Londër, Kajro, Toronto, Athinë, Beograd, Plovdiv, Lion, në sallën plenare të OKB në Gjenevë dhe është vlerësuar maksimalisht nga kritika, mediat dhe personalitetet e artit të vendeve përkatëse.

Mirush Kabashit, për vlerat e tij si artist, i është akorduar nga Presidenti vlerësimi: “Artist i Merituar” (1983), “Mjeshtër i Madh i Skenës” (1998) dhe “Nderi Kombit” (2014).

Ai është nderuar edhe nga bashkitë dhe komunat: Durrës, Gjakovë, Zhelinë, Oslome me titujt “Qytetar Nderi” dhe me vlerësimin “Nderi Kombit” nga komuna e Oslomesë.

Mirush Kabashi është njëri nga artistët më të vlerësuar shqiptar brenda hapësirës shqiptare, por edhe jashtë saj.

II. Arsyetimi i dhënies së titullit Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës

Jeta e aktorit Mirush Kabashi ka qenë e lidhur me teatrin, me këtë univers të kondensuar, që njeriut ia ka përcjellë nga lashtësia të vërtetat më të trishta të ekzistencës njerëzore.

Mirush Kabashi, nëpërmjet artit të aktrimit, i shprehur nëpërmjet lojës aktoreske, diksionit, plasticitetit dhe transformimeve emocionale, ka përcjellë deri te publiku mesazhet universale të veprave madhore kombëtare dhe botërore, kurse si intelektual ka përcjellë mesazhet më humane për lirinë, demokracinë dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

Ai është fiksuar në kujtesën e spektatorit me shumë role të papërsëritshme, qoftë në teatër apo në film.

Mirush Kabashi, me talentin e tij, arriti që të krijonte figura të paarritshme, të cilat janë fiksuar në mbamendjen e publikut.

Duke e vlerësuar dhe çmuar një aktor të këtyre përmasave, gjykojmë se ne e çmojmë dhe e respektojmë gjenin e artit, e çmojmë bukurinë, urtësinë dhe lëmë pas një model orientues edhe për brezat e ri. Pra, ata që kanë lënë vepra nëpërmjet përkushtimit të tyre të pashoq, do të kujtohen dhe do të nderohen në vazhdimësi.

Propozim-vendim

Me sa u parashtrua më lart, por edhe duke u bazuar në personalitetin dhe aktivitetet tashmë të dëshmuara të z. Mirush Kabashi në fushën e artit dhe kulturës dhe në spektrin e gjithëmbarshtëm shoqëror, që ngërthejnë në vete shpirtin human, arsimdashës dhe kombëtar, Komisioni vlerësues jep miratimin për dhënien e titullit Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës z. Mirush Kabashit dhe njëkohësisht i propozojmë Senatit, si organ më i lartë i Universitetit, që vlerësimin tonë ta marrë në konsideratë dhe z. Mirush Kabashin ta shpallë Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës. Si anëtar të Komisionit vlerësues dhe në emër të Universitetit të Tetovës dhe popullit shqiptar të këtyre trevave, jemi të bindur se me këtë akt ne përmbushim një detyrim moral dhe kombëtar, si dhe shprehim mirënjohjen tonë ndaj punës dhe veprës së palodhur të këtij aktori dhe intelektualit të veçantë.

Tetovë, nëntor 2019

Komisioni në përbërje:

1. Prof. Mr. Nafi Jashari - kryetar

2. Prof. Dr. Salajdin Salihu – anëtar

3. Prof. Miltiadh Kutali – anëtar
